



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 20.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.09.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuar për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime" me nr. prokurimi 206-24-8224-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE MEDPLUS SH.P.K. e datës 16.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuar për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime" me numer prokurimi 206-24-8224-1-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 09.09.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 09.09.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, e kthen në rivleresim aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuar për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime" me numer prokurimi 206-24-8224-1-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.09.2024, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 12.08.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 02.09.2024, ku kanë marrë pjesë 3 ofertues.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 09.09.2024 ku është rekomanduar për kontratë "BRT Pharm SHPK dhe neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentacion dhe kemi marr dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë ku kemi vërejt se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Në FDT tek neni 9.1&9.2 është kërkuar "2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se secili produkt në listën për tenderim, ka Autorizim për Marketing në Kosovë. Ky kriter nuk vlen për artikujt e materialit shpenzues".

Kurse dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar:

2. OE duhet të dëshmojë se secili produkt në Listën e produkteve me të cilën oferton, është i regjistruar në Regjistrin e produkteve të regjistruara në AKPPM, në kohën e ofertimit, me numrin e Autorizim marketingut. Ky kriter nuk vlejne për artikujt e materialit Shpenzues.

Tek përshkrimi i çmimeve në listë është kërkuar që të shënohet numri i Autorizim Marketingut (AM), ndërsa në rubrikë po ashtu AK-së e ka shënuar si më poshtë:

SHENIM: AK do te verifikoj numrin e Autorizim marketingut te shënuar me Regjistrin e produkteve te regjistruara ne AKPPM.

OE i rekomanduar për kontratë tek rubrika ku është dashur të shënohet numri i Autorizim Marketingut (AM) ka shënuar vetëm Linqe dhe nuk ka shënu numër të AM për asnjërin produkt sipas kërkesës së AK-së, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet për këtë arsye.

Autoriteti kontraktues nuk ka bërë verifikim të autorizim marketingut të këtij operatori ekonomik.

Produktet me numër rendor tek lista e përshkrimit të çmimeve 21,51, 95, 98, 122 rezulton qe nuk kanë Autorizim Marketing fare, pra nuk janë të regjistruar në Kosovë dhe këtë është dashur ta verifikojë autoriteti kontraktues.

Duke pasur parasysh këtë fakt dhe këto dëshmi, rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme sepse këto produkte nuk kanë autorizim marketing.

Për këto produkte nuk mundet me ofru autorizim marketing asnjëri operator ekonomik duke përfshire edhe OE e rekomanduar për kontratë, OE MATKOSPHARM SHPK e po ashtu edhe neve.

Duke pasur për bazë këto dëshmi vijmë në përfundim se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të hiqet kërkesa për autorizim marketing për këto produkte të cilat nuk kanë autorizim marketing ose te largohen nga lista produktet qe nuk jane te regjistruara, në të kundërtën projekti dështon përsëri.

Edhe OE MATKOSPHARM SHPK është i papërgjegjshëm, sepse për produktet e lartpërmendur nuk ka mund të dëshmojë se kanë AM.

Ky OE për produktin nr.21, 95 e ka shënuar import pa paralele, kurse për produktin nr. 51 ka shenuar nr. AM te produktit me forme tjeter farmaceutike, per produktet nr. 98 dhe 122 i ka shenuar nr. te AM-ve me doza tjera farmaceutike.

Këta numra është dashur ti verifikojë autoriteti kontraktues ashtu siç e ka shënuar, mirëpo nuk ka asnjë dëshmi se e ka ndërmarr këtë veprim.

Sidoqoftë ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk ka shënuar numrat e AM për secilin produkt ashtu siç është kërkuar.

Duke pasur parasysh që produktet me numër rendor tek lista e përshkrimit të çmimeve 21, 51, 95, 98, 122 nuk kanë Autorizim Marketing fare, pra nuk janë të regjistruar në Kosovë, atëherë edhe ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Autoriteti kontraktues me rastin e hartimit të paramasës dhe listës së përshkrimit të çmimeve është dashur të analizojë se këto produkte a kanë AM dhe cilat produkte kanë, prandaj është dashur ti vendos në listë për furnizim vetëm produktet që kanë AM ose të mos kërkojë fare AM. Me këto kërkesa tenderi është i dështuar dhe duhet të anulohet në tërësi sepse nuk kemi trajtim të barabartë të të gjithë ofertuesve.

Nëse nuk ka autorizim marketing produkti për ne atëherë nuk ka edhe për OE rekomanduar për kontratë dhe për të gjithë të tjerët, prandaj duhet të bëhen verifikimet për produkte se a kanë AM a jo.

Nga dëshmitë që u cekën më lartë dhe provat shkresore rezultojnë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse nuk janë trajtuar të gjithë ofertuesit në mënyrë të barabartë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Kurse paragrafi 6 pika vi parasheh që "që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse", ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit.

Nga të gjeturat dhe konstatimet e lartcekura kuptohet se dosja e tenderit nuk është përgatitur si duhet, sepse AK-së ka kërkuar AM për produktet që nuk kanë AM dhe nuk janë të regjistruara në Kosovë.

AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerret:

VENDIM

I. APROVOHET, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE MEDPLUS SH.P.K

II. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kerkesen tuaj per rishqyrtim dhe konsiderojme se pretendimet jane te bazuara.

Sipas rrjedhes se procesit, ne hartimin e listes se produkteve per tenderim, jane leshuar disa gabime, disa produkte jane pershkruar me doza qe nuk jane te regjistruara ne treg. Produktet e njejta jane te regjistruara por kane doza tjera, andaj nuk jane te pranueshme per mos plotesim te specifikimit te kerkuar.

Komisioni vleresues gjate vleresimit te ofertave, nuk i ka verejtur se keto produkte nuk jane te regjistruara, sipas dozave te kerkuara.

Sipas Dosjes se Tenderit, te FTD, ka qene e specifikuar e drejta juaj per pyetje sqaruese pika 16.1 deri me dt. 21.08.2024 , por ju nuk keni paraqitur pyetje per sqarime shtese, keni ofertuar pa i trajtuar keto defekte, nuk e keni plotesuar listen e AM per keto produkte.

Sikur ju te benit pyetje sqaruese ne fazen e tenderimit, ne si AK do ta benim korrigjimin apo largimin nga lista te atyre produkteve dhe aktiviteti do te vazhdonte me sukses.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit